



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.325, datë 20.10.2023

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN ORNELA RRUMBULLAKU”

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164 pika 8, nenin 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Ornela Rrumbullaku, si staf akademik me kohë të pjesshme në Universitetin “Epoka”, në vitin akademik 2023-2024, me një ngarkesë totale prej 64 (gjashtëdhjetë e katër) orë mësimore gjatë semestrit të vjeshtës, për studentët e vitit të tretë të programit të integruar të ciklit të dytë në “Drejtësi”.
2. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Ornela Rrumbullaku, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 20.10.2023.

KRYETAR

